

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE 3 SHKURT 2022

Të nderuar qytetarë,

Prej kohësh ndiqni një teatër të nxitur nga ish-drejtuesja e seancës, nga Nënkrjetarja e Kuvendit, ku, në shkelje të Rregullores, në shkelje të dinjitetit dhe pa respektuar asnjë prej deputetëve që ka regjistruar fjalën, i jep fjalën ish-kryetarit të Partisë Demokratike, duke gjetur pretekste komunikative në bashkëpunim, nëse doni, edhe me kryetarin e grupit, edhe me ministren këtu mbrapa, për t'u marrë kohën deputetëve dhe duke i dhënë kohën, në tejkalim të çdo afati të përcaktuar nga Rregullorja, qoftë në 3-minutëshin e procedurës, qoftë duke e dhënë fjalën në emër të deputetëve të Partisë Demokratike apo qoftë gjatë për përmendje emrash për replikë. Një teatër pa diskutim i shpifur, i cili nuk nderon askënd prej jush dhe prej atyre që e zhvillojnë! Kjo është të abuzosh me detyrën dhe të shpërdorosh drejtimin e një seance, duke i fyer që të gjithë deputetët e tjerë, të cilët presin në radhë dhe, pa diskutim, pas çdo gomarllëku që thuhet këtu, mund të kenë një reagim, por askush nuk e bën këtë, në respekt të gjithsecilit prej kolegëve që rrinë në të njëjtin ambient me ne. Nga ana tjetër, pa diskutim, parafolësi pak më përpara flet për Partinë Demokratike.

I ka ardhur dita sot, por të mos harrojmë që të njëjtën gjë besoj, të njëjtën këngë, mund të ketë dëgjuar vetë, kur ka shkuar te "PSV-91-shi", kur e sulmonin këta kolegët e tjerë këtu, me terma edhe më të rëndë, kur dilte me ish-kryetarin e vet të partisë atëherë, me Nanon, po njësoj si tani po përsëritet ngjarja. Të njëjtën gjë, besoj edhe ishministrja që foli pak më përpara jush apo një pjesë tjetër e bashkëpunëtorëve këtu, kur nuk i quanin socialistë, por "99-sha" apo mjaftistë. Kështu që pjesa që merren me Partinë Demokratike, ndërkohë që duhet të ketë një përgjegjësi serioze për ato që diskutohen në Kuvend dhe për shqetësimet serioze që kanë qytetarët, është e turpshme dhe lidhet me një koncept pronësor që e ka gjithsecili këtu nga të gjitha krahët, një koncept pronësor që do të doja ta thosha pak më përpara, kur kisha fjalën, për ta pasur dhe për ta diskutuar: askush nuk është Partia Demokratike, siç u tha pak më përpara, që "ma jepni fjalën, se u përmend Partia Demokratike". Partia Demokratike është një pasuri publike, një pasuri e qytetarëve shqiptarë, një pasuri e ndërtaur me mundin, sakrificën, djersën, madje gjakun e shumë demokratëve, të cilët kanë dhënë gjithçka për atë parti. Partia Demokratike e Shqipërisë, në koncept pronësor, ku jemi ndarë, nuk është as Sali Berisha, nëse doni ju, as Lulzim Basha, as kryetari tjetër që do të vijë, as ata që kanë qenë përpara, por do të jetë pronë e qytetarëve shqiptarë dhe pronë e demokratëve, të cilët janë jo vetëm bashkaksionerë, por janë njerëz të cilët kanë kontribuar me gjithçka që disa të tjerë të përfitojnë. Edhe në këtë kuptim është një shkelje tjetër, po, me shkelje syri, që i jepet fjala kur diskutohet për të.

Tani, të rikthehem te një marrëveshje, e cila po shitet në këtë parlament dhe po u shitet qytetarëve shqiptarë sikur është një marrëveshje e cila është kërkuar nga qeveria shqiptare, e cila është arritur nga qeveria shqiptare, e cila po u ofron ndonjë arritje qytetarëve shqiptarë. Të pavërteta! E kam pyetur përfaqësuesin e qeverisë në komision dhe kjo marrëveshje, ashtu siç ishte edhe e pritshme dhe nuk kishte ndonjë nevojë të madhe, në fakt, për t'u konfirmuar, është një marrëveshje e kërkuar nga qeveria e Greqisë, ashtu siç erdhi Frontex-i pak më përpara, ashtu si çdo partner tjetër ndërkombëtar dhe shtetet e Bashkimit Europian po kërkojnë t'i vendosin kufizime Shqipërisë apo të kërkojnë informacion si në këtë rast, për shkak se Shqipëria është kthyer në një han pa porta për gjendjen e kriminalitetit. E ndërkohë që erdhi kjo marrëveshje dhe po diskutohej mjaftonte një klikim për të parë shqetësimin që ka qeveria greke, por duhet ta ketë qeveria shqiptare shumë më shumë, pra vetëm

një klikim, për të kërkuar në muajt e fundit: “Ishte furnizuar me drogë në kufi; kapet në Greqi 38-vjeçari shqiptar me mariuhanë; sekuestrohet drogë në Greqi; arrestohet shqiptari; në kufirin Shqipëri-Greqi lulëzon kontrabanda e kanabisit; bandat gjithnjë e më brutale”, - thonë mediet greke. “Njësia kundër drogës zhvillon shumë kontrolle, por shpesh gjen vetëm drogën që kanë lënë kontrabandistët”; në vitin 2020 vetëm të gjetura u sekuestruan mbi 1,5 tonë kanabis; u qëllua me plumb në kokë. Vdes 39-vjeçari shqiptar në Greqi. Dyshohet për larje hesapesh në drogë; trafikantët shqiptarë zbulojnë një rrugë të re për transportin e lëndës narkotike. 38-vjeçari kapet në kamion; policia greke fundos trafikantin shqiptar; kush janë dy shqiptarët e plagosur në Athinë të skeduar për drogë.”, pafundësisht lajme të tilla, të cilat tregojnë gjendjen e rëndë të kriminalitetit që është eksportuar edhe në vendin fqinj, që ka detyruar qeverinë e Greqisë të kërkojë një njësi të përbashkët, e cila shkëmben vetëm informacion dhe bën analizë rrisht.

Nuk ka asnjë lehtësi për qytetarët. Madje, qeveria shqiptare, në kushtet kur i vjen një kërkesë e tillë, edhe për keq, duhej të negocionte një element që është shqetësues për qytetarët shqiptarë, sidomos në periudhat e festave, qoftë para Krishtlindjes dhe pas Viti të Ri apo qoftë në gusht, ku krijohen radhë kilometrike të qytetarëve shqiptarë që rrinë në pikat doganore të kalimit kufitar me Greqinë, ku të kërkohej pa diskutim ajo që u tha këtu, si e keqe, që nuk do të kemi një pikë të përbashkët kalimi doganor, të kërkohej pikërisht kjo dhe po njësoj të kërkohej jo vetëm në Kakavijë, siç është vendosur kjo qendër, por edhe në Kapshticë, edhe në pikat e tjera të kalimit kufitar, për t’u lehtësuar qytetarët shqiptarë dhe për të mos u favorizuar, edhe në raportet e interesave rajonale apo të qarkut, asnjëri qark përpara qarqeve të tjera. Ministri pak më parë i përmendi si arritje të mëdha lëvizjen e lirë apo marrëveshjen me Frontex-in dhe tha që më parë ngriheshin gardhe. Periudhat, kur ngriheshin gardhet, kanë qenë periudhat kur qeveriste apo dhunonte ishpartia juaj, ashtu siç lëvizja e lirë është zgjidhur jo për shkak të kësaj marrëveshjeje. Lëvizjen e lirë qytetarët shqiptarë e kanë për shkak të mirëqeverisjes dhe të kontributit të Partisë Demokratike në qeverisje për të arritur një nga arritjet më të mëdha për shqiptarët që është liberalizimi i vizave. Për t’u kthyer që a i themi vetëm ne këto, apo i thonë partnerët ndërkombëtarë, ky është një fakt që gjendja e kriminalitetit është e rëndë. Marrëveshja me Frontex-in, për shkak të trafikut të madh të klandestinëve që kalojnë dhe kanë si burim Shqipërinë, është po ashtu një fakt. Marrëveshja me Britaninë e Madhe, që u kalua pak më përpara, dhe ku u vendos si pikë të rëndësishme edhe emigrantët që kalojnë nga Shqipëria, vjen po ashtu si një kërkesë për shkak të rritjes së kësaj veprë penale. Po ashtu, Shqipëria sot, po nga partnerët ndërkombëtarë, është klasifikuar si një ndër vendet ku pastrohen paratë e pista dhe prandaj është në listën gri.

Departamenti Amerikan i Shtetit e përcakton Shqipërinë si një ndër vendet burim për prodhimin e kanabisit dhe si një ndër vendet kryesore, ku bëhet transiti dhe transporti i drogës drejt vendeve të Bashkimit Europian. Nuk ka partner ndërkombëtar, nuk ka strukturë, e cila merret me gjendjen dhe luftën ndaj krimit që të mos e ketë shqetësim. Prokuroria e Katanzaros, strukturat e luftës dhe strukturat ligjzbatuese në Itali kanë po të njëjtin shqetësim. Të gjitha kanë pësuar rritje, ashtu siç ka pësuar rritje që, edhe kur flitet për statistika, kërkohet të manipulohet. Nëse kanë rënë në Shqipëri vrasjet, po themi, vrasjet për shkak të arsyeve ordinere apo krimet ordinere, apo vrasjet të cilat nuk kanë lidhje me krimin e organizuar, pas dëgjësës që ne bëmë me drejtuesit e policisë, as ata nuk e fshihnin dot që është rritur përqindja e vrasjeve, të cilat organizohen nga krimi i organizuar dhe që nuk kanë asnjë autor, por përfundojnë me një lajmërim të policisë, si agjenci lajmesh: “Iku në këtë drejtim, iku në atë drejtim; u dogj makina këtu; ishte makinë e vjedhur aty”. Ne, pa diskutim, duke thënë të gjitha shqetësimet që kemi për këtë marrëveshje dhe për gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri, duke dashur të kishte një negociatë më të rëndësishme dhe më të fortë me palën greke për të pasur më shumë lehtësi për kalimin kufitar të qytetarëve shqiptarë, duke qenë se ata e kanë shqetësim gjendjen e krimit dhe qeveria shqiptare jo, do të donim që kjo marrëveshje të kishte

avancuar më tej. Por, duke qenë se është një marrëveshje ndërkombëtare, e cila, gjithsesi, krijon lehtësi, qoftë edhe përfitim eksperiencash nga pala greke, ne e kemi votuar pro dhe do ta votojmë pro, duke pasur të gjitha këto rezervat që thamë. Faleminderit!